



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 101, datë 31.08.2021

MBI

MIRATIMIN PËR PRISHJEN E DETYRUAR TË GODINËS, QË I PËRKET SHKOLLËS SË MESME MANËZ (KUÇOK), QË MBAN NR. 04, TË LISTËS SË TRANSFERIMIT, QË ME VKM NR. 538, DATË 7.8.2012, BËN PJESË NË LISTËN PARAPRAKE TË PRONAVE TË ISH BASHKISË MANËZ (SOT BASHKIA DURRËS), PËR SHKAK SE ËSHTË DËMTUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE E DATËS 26 NËNTOR 2019 DHE PËRBËN RREZIK PËR JETËN DHE SHËNDETIN, DHE REKOMANDOHET TË DEMOLOHEN, KJO SIPAS AKTEKSPERTIZËS SË THELLUAR, REALIZUAR NGA INSTITUTI I NDËRTIMIT TIRANË, DHE MIRATIMIN PËR HEQJEN NGA KONTABILITETI DHE LISTA PARAPRAKE E PRONAVE, TË GODINËS ME EMËRTIMIN SHKOLLA E MESME MANËZ (KUÇOK), ME VENDODHJE NJËSIA ADMINISTRATIVE MANËZ, QË ME VKM NR. 538, DATË 7.8.2012, BËN PJESË NË LISTËN PARAPRAKE TË PRONAVE TË ISH BASHKISË MANËZ (SOT BASHKIA DURRËS)

Në zbatim të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, VKM-së nr. 538, datë 7.8.2012 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose përdorim të Bashkisë Manëz”, VKM-së nr.796, datë 11.12.2019 “Për një ndryshim në vendimin nr. 408, datë 13.5.2015, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, të ndryshuar, VKM-së nr. 887, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurës së përshpejtuar për hartimin dhe miratimin e planit të detyruar vendor, si dhe procedurës së miratimit të lejeve të zhvillimit/ndërtimit, në rastet e fatkeqësisë natyrore”, Aktit Normativ nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, shkresës nr.371/5 prot., datë 12.07.2021, ardhur nga Instituti i Ndërtimit Tiranë, me lëndë “Dërgim Akt ekspertizave të thelluara”, ligjit

nr. 10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, ligjit nr. 111/2018 “Për kadastrën”, sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Projekteve dhe Infrastrukturës Publike dhe Drejtoria Ligjore, me propozim të Zëvendëskryetares së Bashkisë, e cila kryen funksionet e Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK V E N D O S I :

1. Miratimin për prishjen e detyruar të godinës, që i përket Shkollës së Mesme Manëz (Kuçok), me vendodhje Njësia Administrative Manëz, që mban nr. 04 të listës së transferimit, që me VKM nr. 538, datë 7.8.2012, bën pjesë e listën paraprake të pronave që transferohen në pronësi të Bashkisë Manëz (sot Bashkia Durrës), për shkak se është dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e datës 26 Nëntor 2019 dhe është rekomanduar të demolohet, sipas aktekspertizës së thelluar, realizuar nga Instituti i Ndërtimit Tiranë.
2. Miratimin për heqjen nga lista paraprake të pronës me emërtimin Shkollës e Mesme Manëz (Kuçok), që mban nr. 04 të listës së transferimit, që me VKM nr. 538, datë 7.8.2012, bën pjesë në listën paraprake të ish Bashkisë Manëz (sot Bashkia Durrës).
3. Drejtoria Ekonomike dhe Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve, në zbatim të ligjit nr. 10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, ligjit nr. 111/2018 “Për kadastrën”, të kryejnë veprimet në librat e inventarit ekonomik, përditësimin e listës së pronave të paluajtshme dhe fshirjen në regjistrat e pasurive të paluajtshme Durrës, të pronës me emërtimin Shkolla e Mesme Manëz (Kuçok), që mban nr.04 të listës së transferimit, që me VKM nr. 538, datë 7.8.2012, bën pjesë në listën paraprake të transferimit.
4. Toka (trualli), i liruar nga prishja e godinës, e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, nëse i plotëson kushtet për rindërtim (pasi të studiohet për kushtet gjeologjike dhe sizmike), të përdoret për rindërtimin e godinës, e dëmtuar nga fatkeqësia natyrore.
5. Shpenzimet për shembjen e godinës, e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, të mbulohet nga Inspektoriati Mbrojtjes Territorit Vendor, Bashkia Durrës.
6. Drejtoria Ekonomike, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Projekteve dhe Infrastrukturës Vendore, që bazuar në Aktin Normativ nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, të bashkërendojnë punën me Njësinë Zbatuese, që administron fondet për rindërtim, që transferohen nga Këshilli i Ministrave, prej fondit të rindërtimit, për të realizuar rindërtimin e objektit me

emërtimin Shkolla e Mesme Manëz (Kuçok), si dhe përfshirjen në listën e inventarit dhe dokumentacionin përkatës të ndërtesës, pas realizimit të rindërtimit.

7. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria Ekonomike, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Projekteve dhe Infrastrukturës Vendore dhe Drejtoria Ligjore.

Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar).

KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 31.08.2021



08.03.21 9303/2

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT Durrës



Nr. 0714 prot.

Durrës, më 07.09.2021

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.101 datë 31.08.2021 “Mbi miratimin për prishjen e detyruar të godinës, që i përket shkollës së mesme Manëz (Kuçok), që mban nr. 04, të listës së transferimit, që me VKM Nr. 538, datë 7.8.2012, bën pjesë në listën paraprake të pronave të ish Bashkisë Manëz (sot Bashkia Durrës), për shkak se është dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e datës 26 nëntor 2019 dhe përbën rrezik për jetën dhe shëndetin, dhe rekomandohet të demoloheh, kjo sipas aktekspertizës së thelluar, realizuar nga Instituti i Ndërtimit Tiranë, dhe miratimin për heqjen nga kontabiliteti dhe lista paraprake e pronave, të godinës me emërtimin shkolla e mesme manëz (kuçok), me vendodhje njësia administrative Manëz, që me VKM Nr. 538, datë 7.8.2012, bën pjesë në listën paraprake të pronave të ish bashkisë manëz (sot Bashkia Durrës)”

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

ROLAND NASTO

